



Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe  
EC MA NDRYSHE

# EC MA NDRYSHE RAPORT I PUNËS JANAR-QERSHOR 2015

## QASJE E RE STRATEGJIKE DHE PROGRAMET

Një numër i proceseve të rëndësishme ligjore, institucionale dhe politika kanë nisur në qeverisjen lokale në Kosovë. Në mesin e tyre, ndër më të rëndësishmet janë reforma e qeverisjes lokale, rishikimi i dokumenteve të planifikimit dhe zhvillimit lokal, bashkëpunimi dhe zhvillimi rajonal si dhe legalizimi i ndërtimeve pa leje. Të gjitha këto procese e gjejnë EC-in me një qasje të re strategjike që synon t'i mobilizojë dhe orientojë resurset ekzistuese dhe të ardhshme për të lehtësuar komunikimin mes komunitetit dhe qeverisë lokale në Prizren. Sipas strategjisë së re, EC do të ketë orientim të tërësishëm komunitar, e cila do ta vendosë në pozitën e ndërmetësit për të siguruar pjesëmarrje të njëmendtë qytetarë në vendimmarrje.

Plani Strategjik i EC-it është i ndërtuar mbi tri qëllime strategjike të cilat brenda vetes kanë objektiva strategjike që përshkruajnë në detaje më të mëdha se si do të përmbush dhe të arrijë EC misionin dhe vizionin e saj, respektivisht:

- Rritja e mundësive dhe njohurive për bashkëveprim me qytetarët,
- Kuptim dhe avokim më i mirë rreth nevojave dhe alternativave për përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve,
- Përmbushje e misionit duke menaxhuar me efikasitet resurset njerëzore dhe teknologjike.

Brenda tre viteve të ardhshëm, EC synon të shndërrohet në organizatën lidere të transparencës komunale dhe mobilizimit të komunitetit në nivel lokal. Për realizimin e këtij qëllimi, EC do të zgjerojë aktivitetin edhe në komunat tjera të Kosovës si dhe do të zhvillojë programe dhe mjete të reja të punës.

EC është organizatë e komunitetit që angazhohet për avansimin e demokracisë në nivel lokal në Kosovë. Organizata punon me një numër të konsiderueshëm grupesh të komunitetit, si dhe mirëmban një presion të përhershëm ndaj qeverive lokale për qeverisje transparente dhe llogaridhënëse.

Duke filluar nga janari i vitit 2015, EC funksionon me këto tri programe:

1. *Qyteti Gjithëpërfshirës (mobilizim i komunitetit)* – Mobilizimi i komunitetit përbën thelbin e punës së EC-it. Identiteti i organizatës rrjedh nga angazhimi komunitar. Qyteti Gjithëpërfshirës do të jetë programi më i rëndësishëm i organizatës dhe do të përfaqësojë tiparin dallues të EC-it në raport me organizatat tjera të shoqërisë civile. Pjesë e këtij programi do të jenë veprimet që nxisin aktivizmin qytetar në nivel të grupeve të komunitetit (kryesisht lagjet urbane),
2. *Qeverisja e mirë (monitorim dhe avokim)* – Për t'u siguruar që qeveria lokale vepron në përputhje me kërkesat dhe interesat e grupeve të komunitetit dhe për të mbajtur gjallë presionin publik ndaj autoriteteve, programi i Qeverisjes së Mirë do të strukturohet rreth aktivitetit të monitorimit të transparencës dhe rolit watchdog të organizatës. Monitorimi është një ndër tiparet më dalluese të punës së EC-it, ndërsa ai është dizajnuar në atë formë që do t'i ushqejë dy programet e tjera të organizatës me informacion të bazuar, të shpejtë dhe kredibil.

3. *Hulumtimi (prodhim i dijes)* – Prodhimi i dijes do të jetë një nga sferat e angazhimit të përhershëm të organizatës. Duke ndërtuar mbi produktet e hulumtimit të prodhuara në vitet e fundit, organizata do të ndërtojë një sistem të strukturuar të hulumtimit dhe prodhimit të dokumenteve të politikave. Programi i hulumtimit do të forcojë edhe më tutje kapacitetin prodhues të organizatës dhe do të përmirësojë kompetencën profesionale në fushat e ngushta të angazhimit.

### ***Shtrirja gjeografike***

Fokusi i EC do ishte në Prizren dhe Prishtinë, ndërsa iniciativa të caktuara u realizuan edhe në komunat e tjera, kryesisht ato të rajonit të Prizrenit. Gjatë vitit 2015, EC ka nis zbatimin e Indeksit të Transparencës Komunale, përmes të cilit synon shtrirjen e aktivitetit edhe në pesë komunat tjera të mëdha (Gjakovë, Pejë, Gjilan, Mitrovicë dhe Ferizaj). Brenda tre viteve, EC synon që përmes Indeksit të përfshijë mbi 70% të komunave të Kosovës. Aktiviteti monitorues dhe mbikëqyrës i organizatës nga sivjet është shtrirë edhe në komunat Dragash, Rahovec, Malishevë, Suharekë dhe Shtërpce. Si pjesë e avokimit për mbrojtjen e qendrave historike të Kosovës, përveç QH Prizren, EC nga fillimi i vitit 2015 po i vëzhgon edhe qendrat historike të Gjakovës, Prishtinës, Pejës dhe Mitrovicës.

### ***Trademarks të EC***

Gjatë 2015 dhe viteve të ardhshme, EC synon valorizimin e ekzistuesve, si dhe ndërtimin e *trademarks* të ri, të cilët do të jenë tipare dalluese dhe pika referente të punës së organizatës. Këto janë tiparet dalluese me të cilat EC do të vazhdojë të konkurrojë në sektorin e shoqërisë civile në Kosovë:

- Indeksi i Transparencës Komunale – i bazuar në një metodologji gjithëpërfshirëse dhe profesionale, Indeksi do të synojë që në baza vjetore të vlerësojë nivelin e transparencës (përfshi trendet) së komunave të Kosovës. Indeksi është pjesë e “Transparenca Online”, ndër projektet më afat-gjatë të organizatës, që synon t’i hapë komunat dhe t’i bëjë llogaridhënëse karshi qytetarëve (zgjedhësve),
- Lufta kundër krimeve urbanistike në qytetet e Kosovës – mbikëqyrja e sektorit të urbanizmit është një ndër angazhimet qendrore të punës së organizatës. Sikurse në vitet e kaluara, edhe gjatë viteve 2015 dhe 2016 do të vazhdojë vëzhgimi i përhershëm i urbanizmit në Prizren dhe qytetet tjera të Kosovës,
- Qyteti gjithëpërfshirës, mobilizim i komunitetit për qytete më të mira – gjatë vitit 2015, metodologjia e projektit është modifikuar dhe nga puna me grupet e komunitetit (me bazë identitare) është kaluar në organizimin e njësisve komunitare në nivel të lagjeve të qytetit. Projekti synon përkthimin e nevojave dhe kërkesave të qytetarëve në plane të zbatueshme urbane të qytetit të Prizrenit.

## PROJEKTET

Gjatë pjesës së parë të vitit 2015 është punuar në tetë projekte. Disa nga projektet janë vazhdimësi nga viti 2014 (dhe/ose vitet e mëhershme), ndërsa disa të tjera kanë nisur më 2015. Projektet e organizatës gjatë vitit 2015 kanë patur këtë shtrirje gjeografike brenda Kosovës: Prizren, Mamushë, Malishevë, Suharekë, Dragash, Rahovec, Gjiilan, Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Ferizaj, Mitrovicë, Shtërpce.

### **Transparenca Online e komunave të Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës** *Prill 2014 – Mars 2015*

Në mars 2015 ka përfunduar edhe një cilën një vjeçar i projektit “Transparenca online...”. Gjatë kësaj periudhe, projekti është zgjeruar edhe në Prishtinë. Si rezultat i aktivitetit monitorues dhe mbikëqyrës në tri komunat përkatëse, një numër i madh informacionesh janë prodhuar në formë të komunikatave dhe analizave. Pjesë e projektit në Prizren është edhe Forumi Transparenca, një organizëm i ri, që tubon gazetarët dhe aktivistët e qytetit për t’i koordinuar veprimet që synojnë hapjen e qeverisjes lokale.

### **Indeksi i reformës së transparencës komunale** *Maj 2015 – Mars 2016*

Indeksi është vazhdimësi e projektit “Transparenca online...”, që njëherit shënon momentin e zgjerimit të punës së organizatës në 13 komuna të Kosovës. Paralelisht monitorimit të komunave që është zgjeruar në të gjitha komunat e Rajonit të Prizrenit dhe në komunën e Shtërpçes, projekti do të ketë edhe komponentën e Indeksit, një metodologji e matjes sistematike të transparencës në shtatë komunat e mëdha të Kosovës. Gjatë dy muajve të parë të projektit është punuar kryesisht në njoftimin e komunave të reja me Indeks, përgatitjen e monitoruesve për metodologjinë e Indeksit dhe monitorimin e komunës së Prizrenit.

### **Urbanism Watch – urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm** *Janar – Dhjetor 2015*

Ky është viti i dytë i projektit Urbanism Watch, përmes të cilit organizata vazhdon të kujdestarohet nga afër zhvillimet degraduese ndaj urbanizmit të qytetit, me fokus në Qendrën Historike. Nga viti 2015, projekti zhvillohet bazuar në një matricë të strukturuar të monitorimit të çështjeve kyç të urbanizmit, ndërsa një pjesë e punës hulumtuese po u kushtohet edhe qendrave të tjera historike të Kosovës. Gjatë gjashtë muajve të parë të vitit, projekti ka prezantuar një numër të gjeturash mbi Qendrën Historike të Prizrenit në formë të ndryshme (komunikata, analiza, info-grafika, harta e ndërtimeve pa leje, etj.). Së fundmi, është dorëzuar edhe raporti (kontributi) mbi trashëgiminë kulturore dhe planifikimin urban për Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2015.

## **Qyteti Gjithëpërfshirës – planifikim me pjesëmarrja për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren** *Janar – Dhjetor 2015*

Nga sivjet, Qyteti Gjithëpërfshirës ka filluar punën edhe në nivel të lagjeve të Prizrenit. Gjatë këtyre muajve të vitit, projekti ka nxitur veprime në mbi dhjetë lagje të qytetit, me një numër solid rastesh që kanë gjetur zgjidhje brenda kësaj periudhe. Projekti ka qenë prezent në hapësirën publike përmes performansave, të cilat po i artikulojnë kërkesat e qytetarëve në formën e aktivizmit kulturor dhe urban. Për qëllime të projektit është ndërtuar edhe portali *mahalla.info*, që synon të shndërrohet në adresën kryesore të informacionit mbi gjendjen në lagjet e qytetit.

## **EC për qytete transparente dhe gjithëpërfshirëse** *Qershor 2015 – Maj 2016*

Fondi përkrahës për organizatën, që do të ndihmojë punën e organizatës në një numër projektesh e iniciativash gjatë periudhës një vjeçare. Fokusi i këtij projekti janë aktivitete të hulumtimit dhe avokimit të organizatës mbi transparencën dhe llogaridhënien e komunave të Kosovës, paralelisht me veprimet e mobilizimit të komunitetit. Përmes këtij projekti do të realizohen: punëtorja mbi dokumente të politikave publike (për stafin e EC), info-grafika të të gjeturave nga procesi i monitorimit të komunave, krijimi i një *pool of researchers* me të cilët EC do të krijojë bashkëpunim të rregullt, publikimi i së paku katër dokumenteve të politikave publike dhe pealizimi i së paku një tryeze publike në bashkëpunim me Forumin 2015 në Prishtinë.

## **Lidhja e komunitetit me shërbyesit e drejtësisë (Gjykatë e Hapur)** *Mars 2014 – Dhjetor 2015*

Gjatë vitit 2014, projekti ka ndihmuar Gjykatën Themelore të Prizrenit në strukturimin e njësisë së informimit publik. Nga sivjet, projekti vazhdon në formën e iniciativës “Gjykatë e Hapur” dhe realizohet pa përkrahje financiare. Komponentë esenciale e projektit është lehtësimi i komunikimit të grupeve të komunitetit me shërbyesit e drejtësisë. Zyra për Informim e Gjykatës tashmë operon me një numër mjetesh të përhershme të komunikimit (profilet në mediat sociale, buletini tre-mujor informues, programe ‘vizito Gjykatën’, etj). Në pjesën e parë të vitit 2015 ka filluar edhe programi i praktikës për studentët në Zyrën për Informim të Gjykatës, i cili realizohet në partneritet mes EC, Gjykatës Themelore dhe Universitetit të Prizrenit.

## **Aktivizmi kulturor dhe urban në Prizren** *Prill 2014 – Maj 2015*

Tri vepra të intervenimit artistik në hapësirën publike, publikimi i raportit të hulumtimit dhe konferenca rajonale për aktivizëm kulturor janë realizuar gjatë pjesës së parë të vitit 2015, si vazhdimësi e aktiviteteve të projektit nga viti 2014. Konferenca rajonale e projektit ka sjellë folës të njohur nga vendi dhe shtetet e rajonit (Shqipëri, Serbi dhe Maqedoni), si nismë për një rrjet rajonal të aktivistëve kulturor dhe urban, të cilët angazhohen për shpëtimin e qyteteve nga degradimi i mëtejshëm.

**Zhvillimi rajonal përmes turizmit kulturor në Prizren** *Shtator 2014 – Maj 2015*

Në mesin e vitit 2015, rajoni i Prizrenit u pasurua me një numër produktesh të reja turistike, përfshi edhe një pikë të re turistike të vendosur në qendër të qytetit. Katalogu i rajonit, pesë guida turistike dhe ciceronët elektronik janë të gatshme t'i shërbejnë turistëve në shtatë gjuhë (3 lokale dhe 4 të huaja). Projekti synon të ofrojë një shtytje zhvillimit rajonal përmes promovimit të ofertës turistike të rajonit të Prizrenit.

**Iniciativat tjera**

1. **Forumi Transparenca** – forum i përbërë nga aktivistë të shoqërisë civile dhe gazetarë të Prizrenit që ka për qëllim avancimin e transparencës dhe llogaridhënies së komunës së Prizrenit. Një pjesë e programit për qeverisjen e mirë gjatë vitit 2015 do të bartet në Forumin Transparenca, ndërsa nga viti 2016 EC do të synojë pavarësimin e këtij forumi si entitet që funksionon me kapacitetet e veta dhe i shërben anëtarëve të vetë.
2. **Politikat kulturore lokale (RrOK Prizren)** – rrjetëzimi lokal i skenës së pavarur kulturore është ndër zhvillimet më të rëndësishme në sektorin e kulturës në Prizren. Si pjesë e këtij rrjeti, EC ka vazhduar të angazhohet për zhvillimin e politikave kulturore lokale në Prizren, që do të sigurojnë zbatim konkret të zotimeve për zhvillim ekonomik përmes kulturës të vendosura në Planin Zhvillimor Komunal 2025 të Prizrenit.
3. **Kino Lumbardhi** – iniciativa për mbrojtjen e kinos ka ofruar një shembull të mirë se organizimi dhe bashkimi mund të sjellë efekte të dëshiruara. Angazhimi për Kino Lumbardhin ka vazhduar edhe gjatë pjesës së parë të vitit 2015, duke rezultuar në ndaljen e përkohëshme të privatizimit dhe kthimin e kinemasë në shërbim të komunitetit. Nga muaji Maj, Kino Lumbardhi ofron program kulturor në baza ditore.
4. **Rrjetëzimet** – EC ka vazhduar të konsolidojë pozitën e vet brenda rrjeteve nacionale dhe rajonale, ndërsa si pjesë e tyre ka ndihmuar në iniciativat e shoqërisë civile në nivelin qendror, përfshi zbatimin e strategjisë së bashkëpunimit mes qeverisë dhe shoqërisë civile (përmes Civikos), hartimin e strategjive shtetërore të kulturës dhe trashëgimisë kulturore (përmes Forumit Kulturor), etj.
5. **Strategjia shtetërore për trashëgimi kulturore** – EC është pjesë e grupit punues që po harton Strategjinë, ndërsa kontributin e ngushtë po e ofron në objektivin mbi zhvillimin e qëndrueshëm. Strategjia për trashëgimi kulturore është njëra nga kërkesat më të përsëritura të EC viteve të fundit, ndërsa paraqet një moment të ri për politikat kulturore në Kosovë.

6. **Programi për Zhvillim të Trashëgimisë** – si pjesë e Programit të Këshillit të Evropës për trashëgimi kulturore dhe diversitet, EC gjatë viteve të kaluara ka mbuluar rajonin e Prizrenit. Gjatë pjesës së parë të vitit 2015, EC ka koordinuar Programin për Zhvillim të Trashëgimisë për rajonin e Prizrenit duke qenë një nga bartëset e hartimit të Planit Rajonal të Trashëgimisë Kulturore. Gjatë vitit 2015 EC do të nënshkruaj marrëveshje bashkëpunimi me gjashtë komunitat e rajonit dhe do të angazhohet në zbatimin e këtij Plani.

## PUBLIKIMET

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2015, organizata ka realizuar pesë publikime, përfshi analiza, dokumente të politikave, raporte, studime hulumtuese, buletinë dhe video produkte.

**Grupet e komunitetit dhe planifikimi urban në Prizren** – Ky është viti i dytë i publikimit “Qyteti gjithëpërfshirës”, që përmbledh raportet e shtatë ekspertëve, detyra e të cilëve ishte t’i strukturojnë të gjeturat e një cikli të gjatë hulumtues dhe t’i paraqesin ato në formë të dokumenteve udhëzuese për qeverinë lokale të Prizrenit, si kontribut për procesin e planifikimit urban.

**Numri i dytë i dhe i tretë i buletinit “Gjykatë e Hapur”** – Gjykata Themelore e Prizrenit ka publikuar numrin e dytë dhe të tretë të buletinit informativ “Gjykatë e Hapur”. Buletini është një dritare e re e transparensës së punës së Gjykatës Themelore të Prizrenit, që synon fuqizimin e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë në përgjithësi dhe në punën e Gjykatës në veçanti. Ky publikim periodik ofron informacion mbi punën e Gjykatës, statistikat e trajtimit të lëndëve, aktivitetet dhe projektet, qasjen e qytetarëve në Gjykatë, përfshirjen mediale, dhe të tjera në shërbim të transparencës dhe llogaridhënies karshi qytetarëve.

**(Pa) drejtësia në urbanizmin e Prizrenit** – Thirrjet e publikut për mbrojtjen e Qendrës Historike të Prizrenit nuk po merren parasysh nga institucionet e pushtetit ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, si në nivelin lokal ashtu edhe atë qendror. Ky raport është dëshmi e rradhës që institucionet, edhe pse kanë detyrime të qarta ligjore për të vepruar në ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, prej vitesh kanë vendosur që t’i mbyllin sytë dhe veshët kundruall degradimit urbanistik në këtë zonë, duke instaluar në mënyrë të heshtur kulturën e pandëshkueshmërisë.

**Plani Rajonal i Trashëgimisë për Rajonin Jug** – Plani i Trashëgimisë është një mjet i dobishëm i cili do të krijojë një platformë për palët e interesuara për të bashkuar forcat nën një strategji rajonale dhe për të shtruar rrugën për një marrëdhënie më të fuqishme në mes të veprimeve bazë dhe politikë bërjes në nivel qendror, duke ofruar një qasje dinamike dhe sistematike ndaj proceseve të zhvillimit lokal përmes shfrytëzimit të burimeve ekzistuese të trashëgimisë.

**Katalogu i Rajonit Jug “Bukur dhe Gjelbër”** – Katalogu është produkt i rradhës turistik i rajonit të Prizrenit (gjashtë komuna) dhe përmban atraksione të rajonit të paraqitura në tre kapituj: trashëgimia kulturore, natyra dhe arte. Pjesë e katalogut është edhe harta turistike e rajonit, si dhe pesë gjuida turistike tematike. Të gjitha këto produkte janë publikuar në shtatë gjuhë (katër lokale dhe tre të huaja).